



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**GJYKATA E LARTË
KËSHILLI I GJYKATËS**

Nr. 6341 prot.,

Tiranë, 04.12.2023

NJOFTIM

PËR SHPALLJE PËR LËVIZJE PARALELE, NGRITJE NË DETYRË DHE PRANIMIN NË SHËRBIMIN CIVIL GJYQËSOR NË KATEGORINË E MESME DREJTUESE

Bazuar në ligjin nr. 98/2016 datë 06.10.2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, vendimin nr. 622, datë 10.12.2020 të Këshillit të Lartë Gjyqësor “Për lëvizjen paralele, ngritjen në detyrë dhe pranimin në shërbimin civil”, vendimin nr.643, datë 23.12.2020 të Këshillit të Lartë Gjyqësor “Për miratimin e rregullave standarde për organigramën, përshkrimin e detyrave dhe përgjegjësive të kategorive të punonjësve të Gjykatës së Lartë”, si dhe vendimin nr.1, datë 21.01.2021 të Këshillit të Gjykatës, Gjykata e Lartë, shpall procedurën e lëvizjes paralele dhe pranim në shërbimin civil gjyqësor, për pozicionin si më poshtë: **shpall procedurën e lëvizjes paralele, ngritjes në detyrë dhe pranim në shërbimin civil gjyqësor për :**

- **1 (një) pozicion** – Drejtor, Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse, kategoria e mesme drejtuese, II-2.

Pozicioni më sipër, u afrohet fillimisht nëpunësve civilë gjyqësorë të së njëjtës kategori për procedurën lëvizjes paralele. Vetëm në rast se në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele, rezulton se ky pozicion është ende vakant, ai është i vlefshëm për konkurrimin nëpërmjet procedurës “”ngritje në detyrë “dhe “pranimin në shërbimin civil gjyqësor”.

Për të tria procedurat (lëvizje paralele, ngritje në detyrë dhe pranim në shërbimin civil gjyqësor në nivel drejtues) aplikohet në të njëjtën kohë.

Afati i dorëzimit të dokumentacionit për

Lëvizje paralele

18.12.2023

Afati i dorëzimit të dokumentacionit për

Ngritje në detyrë

26.12.2023

Përshkrimi përgjithësues i punës për pozicionin si më sipër është:

Kërkesa të përgjithshme,

Kandidati duhet të plotësojë të gjitha kërkesat e përgjithshme për “Lëvizje paralele” dhe “Ngritje në detyrë”, në shërbimin civil gjyqësor, sipas ligjit nr. 98/2016 datë 06.10.2016 “ Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë ”, si dhe kushtet e veçanta sipas Vendimit nr. 622, datë 10.12.2020 të Këshillit të Lartë Gjyqësor “Për lëvizjen paralele, ngritjen në detyrë dhe pranimin në shërbimin civil”.

Përshkrimi i përgjithshëm i punës për pozicionin Drejtor është si më poshtë:

- Ndihmon Këshillin e Gjykatës në kryerjen e detyrave që lidhen me hartimin e përshkrimeve të punës, si dhe çështje të tjera që lidhen me statusin e nëpunësve civil gjyqësor sipas ligjit;
- Ndihmon Kryetarin në procesin e vlerësimit periodik profesional sipas ligjit duke përgatitur projektvendimet për vlerësim si dhe të gjitha dokumentet e tjera të nevojshme për kryerjen e vlerësimit profesional;
- Ndihmon Kryetarin në procesin e rekrutimit të punonjësve të tjerë të Gjykatës sipas ligjit duke përgatitur të gjitha dokumentet dhe aktet e nevojshme për këtë qëllim;
- Përgjigjet për sistemin e menaxhimit të personelit (identifikimin e nevojave për personelin, rekrutimin, risistemimin e personelit të tepërt, trajnimin e fillestarëve, organizimin e strukturave, përgatitjen e projektit të strukturës dhe organigramës dhe të organikës.
- Merr masa për t'i plotësuar personelit të Gjykatës së Lartë materialet e nevojshme kancelarike dhe çdo pajisje tjetër;
- Kujdeset që projektbuxheti për vitin pasardhës të hartohet në kohë sipas nevojave dhe kërkesave të njësisë të tjera organizative në bashkëpunim me sektorin e menaxhimit financiar;
- Në bashkëpunim me drejtorët e drejtorive, harton planin e kualifikimit dhe të specializimeve për punonjësit.
- Kujdeset për plotësimin e kërkesave për karburant e pjesë këmbimi të automjeteve të institucionit dhe siguron gatishmërinë e mjeteve,
- Kujdeset për kryerjen e punimeve dhe shërbimeve për mirëmbajtjen e ndërtesës dhe të zyrave, për sigurimin me energji elektrike dhe lidhje telefonike, si dhe për krijimin e lehtësirave të nevojshme për veprimtarinë e Gjykatës së Lartë;
- Merr masa për riparimin dhe shërbimet e nevojshme për mirëmbajtjen e automjeteve, të pajisjeve dhe aparaturave dhe kur konstatohet se dëmtimet e tyre kryhen me faj, nxjerr përgjegjësinë personale dhe parashtron propozimet për zhdëmtim;
- Kontrollon përdorimin me korrektësi të mjeteve, pajisjeve dhe automjeteve, si dhe ndalon çdo keqpërdorim e shfrytëzim abuziv të tyre;
- Ndjek procesin e respektimit të marrëdhënieve të punës në të gjitha strukturat.
- Kryen detyra të tjera, sipas urdhrave apo porosive të Kryetarit, Kancelarit apo Këshillit të Gjykatës.

- Administron bazën e të dhënave të punonjësve fizikisht dhe elektronikisht sipas sistemit.
- Mbron interesat e punonjësve dhe të shoqërisë në përputhje me politikat e Burimeve Njerëzore dhe ligjeve në fuqi.

I. LËVIZJA PARALELE

Kanë të drejtë të aplikojnë për këtë procedurë vetëm nëpunësit civilë gjyqësorë të së njëjtës kategori.

I.1 KUSHTET PËR LËVIZJEN PARALELE DHE KRITERET E VEÇANTA

Kandidatët duhet të plotësojnë kushtet e përgjithshme për lëvizjen paralele si vijon:

- a- Të jetë nëpunës civil gjyqësor i konfirmuar, brenda së njëjtës kategori – kategoria II-2 (*dokument nga institucioni*)
- b- Të mos ketë masë disiplinore në fuqi (*dokument nga institucioni*)
- c- Të ketë të paktën vlerësimin e fundit “shumë mirë” (*dokument nga institucioni*)
- ç- Të plotësojë kushtet dhe kërkesat e posaçme të përcaktuara në shpalljen për konkurrim.

Kandidatët duhet të plotësojnë kriteret e veçanta si vijon:

- Të zotërojë një diplomë “Master “ ose të barasvlefshëm me të, sipas legjislacionit të arsimit të lartë, në studimet e larta universitare në shkenca juridike. Edhe diploma “Bachelor” duhet të jetë e së njëjtës fushë.
- Të ketë të paktën 5 (vite) përvojë pune, nga të cilat të paktën 2 (dy) vjet përvojë në çështje që lidhen me burimet njerëzore dhe shërbimet mbështetëse.
- Të ketë aftësi të mira profesionale, organizative, etikë të lartë komunikimi dhe të punës në grup.
- Të ketë njohuri në gjuhën angleze ose të një gjuhe tjetër të BE-së, dokument provues, nëse ka.
- Të ketë njohuri praktike në përdorimin e programeve të kompjuterit.

1.2 DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT

Kandidatët duhet të dorëzojnë me postë ose pranë protokollit, të Gjykatës së Lartë brenda datës **18.12.2023**, dokumentet si më poshtë vijon:

- Jetëshkrimi i plotësuar në përputhje me dokumentin tip që e gjeni në linkun:
- [http://dap.gov.al/vende -vakante/udhezime-dokumenta/219-udhezime-dokumenta](http://dap.gov.al/vende-vakante/udhezime-dokumenta/219-udhezime-dokumenta).
- Kërkesë motivimi për aplikim për vendin e lirë të punës.
- Fotokopje e diplomës dhe të listës së notave (përfshirë edhe diplomën Bachelor).
- Fotokopje e librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë).
- Fotokopje e letërnjoftimit (ID).
- dh- Vërtetimin e gjendjes shëndetësore.
- Vërtetimin e gjendjes gjyqësore.
- Vlerësimet e fundit nga eprori direkt.
- Vërtetimin nga institucioni që nuk ka masë disiplinore në fuqi.

- Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj.
- Aktin e deklaramit të statusit të nëpunësit civil gjyqësor.
- Kontaktet (numër telefoni dhe adresë email) dhe adresën e plotë të vendqëndrimit.

Mosparaqitja e plotë e dokumentacionit sjell skualifikimin e kandidatit.

Ankesat nga kandidatët e pakualifikuar paraqiten në Gjykatë, brenda 2 (dy) ditëve kalendarike nga data e njoftimit individual dhe ankuesi merr përgjigje brenda 2 (dy) ditëve kalendarike nga data e depozitimit të saj.

1.3 REZULTATET PËR FAZËN E VERIFIKIMIT PARAPRAK

Kancelari i gjykatës verifikon kandidatët që plotësojnë kushtet për lëvizjen paralele dhe kërkesat e veçanta, të cilat përcaktohen në shpalljen e konkurrimit, dhe përgatit listën e kandidatëve të kualifikuar, jo më vonë se 2 (dy) ditë kalendarike nga përfundimi i afatit të paraqitjes së kërkesave për kandidim.

Në datën **20.12.2023**, Kancelari do të shpallë në faqen zyrtare të internetit të Gjykatës së Lartë, në rubrikën “*Marrëdhënie me publikun-vende vakante*”, listën e kandidatëve që plotësojnë kushtet e përgjithshme të lëvizjes paralele dhe kriteret e veçanta, si dhe **datën, vendin dhe orën** e saktë ku do të zhvillohet intervista.

Në të njëjtën datë kandidatët që nuk plotësojnë kushtet e lëvizjes paralele dhe kriteret e veçanta do të njoftohen individualisht për shkaqet e moskualifikimit (nëpërmjet adresës së e-mail).

1.4 MËNYRA E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me dokumentacionin e dorëzuar:

Këshilli, brenda 2 (dy) ditëve nga përfundimi i verifikimit paraprak dhe i procedurave të ankimit, fillon vlerësimin profesional të kandidatëve. Totali i pikëve të vlerësimit të kandidatëve është 100 (njëqind), si më poshtë:

- 40** (dyzet) pikë për rezultatet e vlerësimit në punë. Në rast rezultatesh të njëjta, Këshilli krijon një renditje brenda grupit të kandidatëve me vlerësimin më të lartë të punës;
- 50** (pesëdhjetë) pikë për vitet e përvojës profesionale në pozicionin përkatës si dhe vitet e përgjithshme të përvojës profesionale, në sektorin e drejtësisë ose përvojën profesionale që lidhet me fushën e pozicionit përkatës, si dhe,
- 10** (dhjetë) pikë për trajnimet apo kualifikimet e lidhura në fushën përkatëse.

Kandidati që merr më pak se **70** (shtatëdhjetë) pikë nuk konsiderohet i suksesshëm. Këshilli i Gjykatës zgjedh kandidatin, i cili renditet i pari me pikë maksimale, për t’u emëruar në vendin e lirë.

1.6 DATA E DALJES SË REZULTATEVE TË KONKURIMIT DHE MËNYRA E

KOMUNIKIMIT

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, informacioni për fituesin do të shpallet në faqen zyrtare të internetit të Gjykatës së Lartë, në rubrikën “*Marrëdhënie me publikun*“, në datën **04.01.2024**

II . KONKURIMI NËPËRMJET PROCEDURËS SË NGRITJES NË DETYRË

*Vetëm në rast se nga pozicionet e renditura në fillim të kësaj shpalljeje, në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele, rezulton se pozicioni i shpallur është ende vakant, ky pozicion është i vlefshëm për konkurrim nëpërmjet procedurës së ngritjes në detyrë. Këtë informacion do ta merrni në rubrikën e njoftimeve të Gjykatës së Lartë, duke filluar nga data **20.12.2023**.*

Për procedurën e “Ngritjes në detyrë” kanë të drejtë të aplikojnë vetëm nëpunësit e punësuar në të njëjtin apo në një institucion tjetër të shërbimit civil gjyqësor, që plotësojnë kushtet për ngritjen në detyrë dhe kërkesat e veçanta për vendin e lirë, sipas ligjit 98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, dhe ligjit 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar.

Kanë të drejtë të aplikojnë për këtë procedurë vetëm nëpunës civil gjyqësor të një kategorie paraardhëse, (kategoria III-1) nga të gjithë institucionet pjesë e shërbimit civil gjyqësor, që plotësojnë kushtet minimale për ngritjen në detyrë dhe kërkesat e posaçme për vendin e lirë, sipas kuadrit ligjor në fuqi.

Kushtet e përgjithshme dhe kriteret e veçanta që duhet të plotësojë kandidati janë të njëjta me ato të “Lëvizjes paralele”.

II.1. DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT

Kandidatët duhet të dorëzojnë këto dokumente deri më datë **26.12.2023**:

- Jetëshkrimi i plotësuar në përputhje me dokumentin tip që e gjeni në linkun: <http://www.dap.gov.al/legjislacioni/udhezime-manuale/60-jeteshkrimi-standard>
- Letër motivimi për aplikim për vendin vakant.
- Fotokopje e diplomës dhe listës së notave (përfshirë edhe diplomën Bachelor).
- Fotokopje e librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë).
- Fotokopje e letërnjoftimit (ID).
- Vërtetimin e gjendjes shëndetësore.
- Vërtetimin e gjendjes gjyqësore.
- Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj.
- Vërtetimin nga institucioni i fundit ku ka punuar, që nuk ka masë disiplinore në fuqi.
- Aktin e deklarimit të statusit të nëpunësit civil në nivelin e ulët drejtues.
- Kontaktet (numër telefoni dhe adresë email) dhe adresën e plotë të vendqëndrimit.

Mosparaqitja e plotë e dokumentacionit sjell skualifikimin e kandidatit.

II.2 REZULTATET PËR FAZËN E VERIFIKIMIT PARAPRAK

Në datën **28.12.2023**, Kancelari do të shpallë në faqen zyrtare të internetit të Gjykatës së Lartë, në rubrikën e njoftimeve për publikun, listën e kandidatëve që plotësojnë kushtet dhe kërkesat e veçanta me procedurën e ngritjes në detyrë, si dhe **datën, vendin dhe orën** e saktë ku do të zhvillohet testimi i kandidatit.

Në të njëjtën datë kandidatët që nuk plotësojnë kushtet e pranimit të ngritjes në detyrë dhe kriteret e veçanta do të njoftohen individualisht në mënyrë elektronike, për shkaqet e moskualifikimit (nëpërmjet adresës së e-mail ose me celular).

Këshilli, brenda **2(dy)** ditëve nga përfundimi i verifikimit paraprak dhe i procedurave të ankimit, fillon vlerësimin e kandidatëve dhe zhvillon një intervistë të strukturuar me gojë. Totali i pikëve të vlerësimit të kandidatëve është **100** (njëqind).

Vlerësimi i kandidatëve përfshin:

a. **70** (shtatëdhjetë) pikë për vlerësimin e dokumentacionit të dorëzuar, që konsiston në vlerësimin e rezultateve të punës, përvojës profesionale dhe trajnimeve të lidhura me fushën përkatëse,

b. **30** (tridhjetë) pikë për intervistën e strukturuar me gojë.

Pikët për dokumentet e paraqitura dhe për intervistën me gojë mbledhen. Kandidati që merr më pak se **70** (shtatëdhjetë) pikë nuk konsiderohet i suksesshëm. Këshilli i Gjykatës zgjedh kandidatin, i cili renditet i pari me pikë maksimale për t'u emëruar në vendin e lirë.

II.3 FUSHAT E NJOHURIVE, AFTËSITË DHE CILËSITË MBI TË CILAT DO TË TESTOHET KANDIDATI

Kandidatët do të testohen në lidhje me:

- Njohuritë dhe aftësitë në lidhje me përshkrimin e pozicionit të punës.
- Eksperiencën e tyre të mëparshme.
- Motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën.

II.4 DATA E DALJES SË REZULTATEVE TË KONKURIMIT DHE MËNYRA E KOMUNIKIMIT

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, Kancelari i Gjykatës së Lartë, do të njoftojë për fituesin e shpallur nga Këshilli i Gjykatës në faqen zyrtare, në rubrikën e njoftimit për publikun, brenda **datës 11.01.2024**. Të gjithë kandidatët pjesëmarrës në këtë procedurë do të njoftohen individualisht në mënyrë elektronike për rezultatet (nëpërmjet adresës së e-mail).

III .1. PRANIM NË SHËRBIMIN CIVIL GJYQËSOR NË NIVEL DREJTUES

*Vetëm në rast se nga pozicionet e renditura në fillim të kësaj shpalljeje, në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele dhe ngritjes në detyrë rezulton se pozicioni i shpallur është ende vakant, ky pozicion është i vlefshëm për konkurrim nëpërmjet procedurës së pranimit në shërbimin civil gjyqësor në nivel drejtues. Këtë informacion do ta merrni në faqen e internetit të Gjykatës së Lartë, në rubrikën “Marrëdhënie me publikun – vende vakante “, duke filluar nga data **28.12.2023**.*

Kushtet e përgjithshme që duhet të plotësojnë kandidati në procedurën e “Pranimit në shërbimin civil gjyqësor” janë:

- Të mos ketë masë disiplinore në fuqi (dokument nga institucioni);
- Të ketë të paktën vlerësimin e fundit „mirë“ apo „shumë mirë“;
- Të mos kenë procese gjyqësore, civile, penale, administrative në proces, si dhe të mos jenë në ndjekje penale nga prokuroria;
- Të plotësojë kushtet dhe kërkesat e posaçme të përcaktuara në shpalljen për konkurim;

Kandidatët duhet të plotësojnë kriteret e veçanta të vendosura për procedurën e “Lëvizjes paralele”, si më sipër.

Të gjithë kandidatët që aplikojnë për procedurën e pranimit në nivelin drejtues, do të marrin informacion në faqen e Gjykatës së Lartë dhe të KLGJ-së , për fazat e mëtejshme të procedurës:

- **Për datën e daljes së rezultateve të verifikimit paraprak.**

- **Datën, vendin dhe orën ku do të zhvillohet konkurrimi.**

Kandidatët që aplikojnë sipas kësaj procedure duhet të dorëzojnë dokumentet brenda datës **03.01.2024** (*Dokumentacioni i kërkuar është i njëjtë me atë të “Lëvizjes paralele “dhe të “Ngritjes në detyrë “*)

Mosparaqitja e plotë e dokumentacionit sjell skualifikimin e kandidatit.

III.2.MËNYRA E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE

Kandidatët do të vlerësohen:

a. 60 (gjashtëdhjetë) pikë për testimin me shkrim.

b. 40 (dyzet) pikë për intervistën e strukturuar me gojë nga Këshilli i Gjykatës.

Kandidatët në testimin me shkrim, do të vlerësohen në lidhje me njohuritë mbi:

- Ligjin nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar;
- Ligjin nr. 98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;
- Ligjin nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve të RSH”, i ndryshuar;
- Ligjin nr. 9887, datë 10.03.2008, i ndryshuar me ligjin nr. 48/2012 “Për mbledhjen e të Dhënave Personale”;
- Ligjin nr. 152/2013 “ Për nëpunësit civil”, i ndryshuar dhe akteve nënligjore të dala në zbatim të tij;
- Ligjin nr. 9131, datë 08.09.2003 “ Për rregullat etike në administratën publike”.
- Kuadri ligjor në fuqi për prokurimet publike
- Ligji nr.7962, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i RSH”(i ndryshuar)

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, Kancelari do të njoftojë për fituesin e shpallur nga Këshilli i Gjykatës në faqen zyrtare, në rubrikën e njoftimit për publikun, brenda datës **25.01.2024**. Të gjithë kandidatët pjesëmarrës në këtë procedurë do të njoftohen individualisht në mënyrë elektronike për rezultatet (nëpërmjet adresës së e-mail).

KËSHILLI I GJYKATËS

GJYKATA E LARTË

Rr. Ibrahim Rugova, Nr.20, 1001 Tiranë